



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



## KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

### RREGULLORE

PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË  
DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE

Klinë, Janar 2016

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja s) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), dispozitave te Konventës për te Drejtat e Fëmijës te dt.20 nëntor 1989 e cila ka hyre ne fuqi me 2 shtator 1990, dispozitat e Ligjit për Kontrollin e Duhanit nr.04/L-156, dispozitave të nenit 40 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt. 31.03.2010, Kuvendi Komunës së Klinës, në mbledhjen e vetë të rregullt të paren (I) më radhë për vitin 2016, të mbajtur me, dt. 29/01/2016, miratoi:

## RREGULLOREN

### PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE

#### I. Dispozitat e përgjithshme

##### Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve. Kushtet në të cilat personat fizik, organizatat tregtare dhe shërbyese, mund t'u ofrojnë në shitje ose shërbime tjera që janë të ndaluara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, e që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve.

##### Neni 2 Përkufizimet

1. Të mitur konsiderohen personat prej moshës 14 deri në 18 vjeç.
2. Personat prej moshës 14 deri 16 vjeç, konsiderohen të mitur të rinj, ndërsa personat prej moshës 16 deri 18 vjeç janë të mitur të rritur.
3. Dispozitat e kësaj rregullore vlejnë edhe për personat nën moshën 14 vjeçare.
4. Dukuri negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve konsiderohen: konsumimi i alkoolit, duhanit, narkotikëve të ndryshëm, shfaqjet me përbajtje jo te përshtatshme, frekuentimi i të rinjve në lokalet e ndryshme në orët e vona etj.
5. Vende publike janë hapësirat, lokalet e ndryshme hoteliere shërbyese dhe tregtare, kafiteritë, internet kafet, institucionet kulturore, objektet edukativoh-arsimore, kinematë dhe lokalet e natyrës së tillë.

##### Neni 3 II. Dispozitat Themelore

1. Ndalohet rreptësisht shitja dhe përdorimi i të gjithave pijeve alkoolike dhe duhanit brenda objekteve edukativoh-arsimore.
2. Të gjitha subjektet nga neni 2 paragrafi 5 të kësaj rregullore, janë të obliguara që në hyrje apo në brendi të vendosin tabelën (shenjën) për ndalimin e shitjes dhe shërbimit të pijeve alkoolike dhe duhanit për të mitur, konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

3. Ndalohet shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike për të miturit nga subjektet afariste.
4. Ndalohet shitja dhe shërbimi me duhan, të miturve nga subjektet tregtare që merren me shitjen dhe shërbimin e tyre.
5. Ndalohet rreptësisht që personat nën moshën 16 vjeçare të shesin pije alkoolike dhe duhan.

**Neni 4**  
**Obligimet e subjekteve të bizneseve dhe të miturit**

1. Të miturit nën moshën 16 vjeçare, mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli vetëm në prani të prindit ose kujdestarit ligjor.
2. Të miturit e rritur mund të qëndrojnë deri në ora 20:00, ndërsa pas orës 20:00, vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Ndalohet hyrja e të miturve në lokalet si: loto, bingo, progoza sportive apo lojëra fati.
4. Organizatorët e shfaqjeve të ndryshme, programeve dhe manifestimeve publike dhe kulturore për të rinjtë në lokalet e mbyllura janë përgjegjës në rast se në ato lokale, lejohet përdorimi i pijeve alkoolike apo duhanit nga të miturit, në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulllore.

**Neni 5**  
**Kinematë, Internet kafetë dhe Shtypi**

1. Kinematë apo subjektet tjera që merren me shfaqje publike të filmave, janë të detyruara që përfëmijët deri në moshën 14 vjeçare të shfaqin ato deri në ora 16:00, prej moshës 14 deri në 16 vjeçare deri në ora 18:00, ndërsa përfshi të miturit prej 16 deri në 18 vjeç deri në ora 20:00.
2. Pas orës 20:00 shfaqjet e tillë të miturit, mund t'i përcjellin vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Kinematë, apo subjektet tjera janë të obliguara që me rastin e shfaqjes së filmave, përbajtja e të cilave ndikon negativisht në formimin e të miturve në aspektin edukativ, arsimor dhe kulturor, të njoftojnë me rastin e reklamimit të filmit si dhe në hyrje të objektit ta kenë shenjën përfshirimin e hyrjes, dhe njëkohësisht janë të obliguara që mos të lejojnë hyrjen e tyre në shfaqje.
4. Internet kafetë janë të obliguara që ta ndalojnë hapjen e web-faqeve të cilat ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit dhe edukimit të tyre.
5. Botuesit dhe shitësit e revistave të ndryshme, përbajtja e të cilave është jo e përshtatshme dhe të cilat ndikojnë negativisht në edukimin arsimor, shëndetësor dhe kulturor të të miturve, nuk mund t'u shesin të miturve deri në moshën 18 vjeçare.
6. Video klubet apo subjektet që merren me shitjen e videokasetave, DVD-ve, CD-ve, përbajtja e të cilave është jo e përshtatshme, janë të obliguara që të mos u shesin dhe të mos u lejojnë përdorimin e tyre, të miturve.

**Neni 6**  
**III. Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat**

- Personi juridik-subjekti afarist, nëse në lokalini e tij shet ose shërben pije alkoolike në kundërshtim me dispozitat nga nenit 3 paragrafi 1,3,4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje, për kundërvajtjen e kryer, do të dënohet me gjobë, njëjtë siç janë të përcaktuara në nenin 103 pika (l) të Ligjit nr. 2004/16 për Veprimtaritë Hoteliere dhe Turistike, ndërsa personi fizik që shkel dispozitat e nenit 3 paragrafi 1,3,4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, dënohet me gjobë mandatorë prej 200.00 €.
- Me gjobë mandatorë në shumë prej 50.00 € do të dënohen:
  - Nëse të miturit i lejohet qëndrimi në restorant apo kafiteri etj, në kundërshtim më dispozitat e nenit 4 paragrafit 1 dhe 2 të kësaj rregullore;
  - Nëse subjektet nga nenit 4 paragrafi 4 veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore;
  - Organizuesit e shfaqjeve, manifestimeve etj, veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga nenit 3 paragrafi 4 të kësaj rregullore.
  - Me gjobë mandatorë në shumë prej 50.00 € do të dënohen personat përgjegjës të subjekteve nga nenit 4, nëse nuk respektohen dispozitat paragrafit 2.1 këtij nenit 4 dhe veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

**Neni 7**  
**IV. Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

Nëse subjektet nuk bëjnë pagesën e gjobave të shqiptuara në pajtim me dispozitat e nenit 6 të kësaj rregulloreje, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së shqiptimit të gjobës, do të iniciohet procedura për ekzekutim në Gjykatën Themelore në Peje Dega në Klinë.

**Neni 8**  
**Zbratzësitrat juridike- ligjore dhe rregullimi i saj**

Në rast të zbrazëtirës juridike nga rregullativa komunale lëndore apo kolisionit të saj me dispozitat përkatëse sistemoare ligjore zbatohen drejtë për se drejti dispozitat sistemoare ligjore te nivelit qendror si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre që rregullojnë çështjen e mbrojtjes se të miturve, deri në harmonizimin e kësaj rregulloreje më legjislacionin pozitiv adekuat.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi e rregullores dhe ndryshimet e plotësimet e saja**

- Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjese për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhet zyrtare në web faqën zyrtare të komunës, kjo në kuptim të nenit 18 të Rregullorës se Qeverisë së Republikës se Kosovës, nr. 01/2013 dt. 24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve komunale.
- Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet në procedurën e njëjtë si përmiratimin e saj.

**Neni 10**  
**Zbatimi dhe mbikëqyrja e rregullores**

1. Zbatimi i kësaj rregulloreje bëhet nga Drejtoria e Inspeksionit ne bashkëpunim me Policinë, si dhe organet e tjera kompetente administrative komunale që janë të obliguara për zbatimin e saj.
2. Kryetari i Komunës e bën mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje.

**Neni 11**  
**Publikimi dhe transparenca e rregullores**

Kjo Rregullore publikohet në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës, si dhe në web faqen zyrtare të Komunës së Klinës, në kuadër të portalit qeveritar, një kopje MAPL-ës në Prishtinë dhe një kopje arhiva.

**KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS**

01Nr. 06-318 /2016  
Klinë, më 29/01/2016

